

RELACION SHPJEGUES
PËR PROJEKTVENDIMIN "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
SPECIFIKE PËR TRANSFERIMIN OSE DHËNIEN ME QIRA TË TË
DREJTAVE TË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti "Për miratimin e rregullave specifike për transferimin ose dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave", vjen si propozim i Ministrit për Infrastruktura dhe Energji, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 71 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Ky projektakt ka për qëllim të miratojë rregullat për transferimin ose dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio midis subjekteve të autorizuar në përputhje me Ligjin Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Projektakti synon të plotësojë kuadrin nënligjor të nevojshëm për zbatimin e Ligjit Nr. 54/2024, si dhe të përafrohet pjesërisht me praktikën dhe parimet e Bashkimit Evropian për administrimin efikas të spektrit të frekuencave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në Planin Analitik të akteve për vitin 2025. Projektvendimi lidhet me zbatimin e ligjit Nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili ka transpozuar Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike", në pikën 4 të nenit 71, parashikon që transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit të frekuencave radio të bëhet në përputhje me rregullat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me anë të këtij projektvendimi “Për miratimin e rregullave specifike për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave”, synohet të përcaktohen rregullat specifike përfshirë procedurat që do ndiqen për të garantuar transparencë, efikasitet dhe konkurrencë të ndershme në menaxhimin e spektrit të frekuencave radio.

Projektakti përbën një hap të rëndësishëm drejt plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit rregullator për administrimin efikas të burimeve të kufizuara të spektrit, në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian.

Miratimi i këtij akti nënligjor plotëson kuadrin nënligjor të parashikuar në Ligjin Nr. 54/2024, lidhur me transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, me qëllim krijimin e një procesi të standardizuar që do zbatohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Ky projektvendim ka rëndësi të veçantë pasi mundëson përdorimin më efikas të spektrit, përmes procedurave të qarta për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit ndërmjet operatorëve duke kontribuar kështu në zhvillimin e konkurrencës dhe inovacionit teknologjik. Njëkohësisht, zbatimi i tij do të sigurojë që çdo transferim ose dhënie me qira të jetë në përputhje me interesin publik, sigurinë kombëtare dhe qendrueshmerinë e zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 71 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk bën përafrim të ndonjë *acquis communautaire* të veçantë, por është hartuar në mbështetje të pikës 4, të nenit 71 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i cila ka transpozuar nenin 51, të Direktivës 2018/1972/EU, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti miraton rregullat specifike për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio midis subjekteve të licencuara me autorizim individual, në zbatim të pikës 4, të nenit 71, të Ligjit Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Projektakti përmban dy nene, ku Neni 1, parashikon miratimin e “Për miratimin e rregullave specifike për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave”, siç është përcaktuar në dokumentin bashkëngjitur projektvendimit. Neni 2, ngarkon Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për zbatimin e këtij vendimi.

Rregullat specifike për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, të përshkruar në dokumentin bashkëlidhur projektaktit dhe përbëhet nga 12 nene si më poshtë:

Në nenin 1, përcaktohet që dokumenti ka për qëllim përcaktimin e rregullave specifike për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave si dhe sigurimin e përdorimit efikas të spektrit në përputhje me objektivat e politikës për spektrin e frekuencave përmes një procesi transparent, jodiskriminues, në mbrojtje të konkurrencës në treg, interesit publik, sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

Në nenin 2, jepen përkufizimet për termat e përdorura në këtë dokument si transferimi i frekuencave ose dhënia me qira e tyre që cilat vijnë në plotësim të termave të përkufizuara në ligjin Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 3, përcaktohen parimet e përgjithshme për procesin duke përcaktuar se transferimi ose dhënia me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio bazohet në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme. Transferimi ose dhënia me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio lejohet vetëm me autorizimin paraprak të AKEP-it, sic përcaktohet në ligj dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme politike të përcaktuara në nenin 5, të ligjit Nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe objektivat e politikës spektrale.

Në nenin 4, përcaktohen kërkesat për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio duke pasur parasysh përcaktimet ligjore në lidhje me këtë proces në veçanti në nenin 71 të ligjit 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe në praktikat e mira të Bashkimit Evropian.

Në nenin 5, përcaktohet procesi i aplikimit pranë AKEP duke sqaruar se procesi do kalojë në disa hapa si njoftimi fillestar për synimin e një transferimi ose dhënie me qira, njoftimi zyrtar, verifikimi paraprak dhe vlerësimi nga AKEP si dhe

vendimi përfundimtar i AKEP. Në këtë nen parashikohet dhe miratimi i formularëve të aplikimit nga AKEP sipas procedurave.

Në nenin 6, përcaktohen detajet e njoftimit fillestar që konsiston në dhënien e një informacioni të përgjithshëm nga palët e interesuara mbi synimin për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të dhëna sipas autorizimit individual. Ky proces është si një hap ndihmues për procesin duke parashikuar dhe udhëzimin e palëve të interesuara për procedurat, kërkesat dhe nëse është i lejuar transferimi sipas parashikimeve ligjore.

Në nenin 7 bëhet përcaktimi i procedurës për njoftimin zyrtar, i cili shoqërohet me aplikimin e plotë të shoqëruar me dokumentacion dhe që i shërben AKEP për të bërë vlerësimin e kërkesës me një fazë apo me Vlerësim të Thelluar në varësi të analizës që kryhet.

Në nenin 8, përcaktohet procesi i verifikimit paraprak të aplikimit zyrtar. Gjatë këtij hapi në veçanti, AKEP kontrollon: nëse janë dhënë të gjitha informacionet e kërkuara; që palët njoftuese kanë një autorizim individual; nëse është një transferim apo dhënie me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave që zbatohet sipas kësaj rregulloreje; që përdorimi i propozuar përputhet me qëllimin/shërbimet e lejuara në një regjim të caktuar autorizimi individual; që të gjitha pagesat, tarifat e radiokomunikacionit për autorizimin individual në lidhje me të drejtat e veçanta të përdorimit janë paguar dhe janë të përditesuara; që nuk ka njoftim(e) apo vendime në lidhje me revokimin ose pezullimin e autorizimit individual që i nënshtrohet transferimi apo dhënia me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave;

Në nenin 9, përcaktohet procedura e vlerësimit me dy faza: faza e parë dhe Vlerësimi i Thelluar në fazën e dytë kur konkludohet e nevojshme. Vlerësimi në fazën e parë bëhet mbi bazën e analizës së një numri kërkesash, dhe për të gjitha aplikimet. Kalimi në Vlerësimin e Thelluar bëhet në rastin kur AKEP ka dyshime se procesi i transferimit ose dhënies me qira mund të çojë në shtrembërime të konkurrencës ose në mospërmbushje të kushteve fillestare të autorizimit. Në këtë nen jepen dhe afatet për të dyja fazat e vlerësimit.

Në këtë nen është parashikuar gjithashtu që AKEP, për çështje që lidhen me konkurrencën të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës siç është e parashikuar në nenin 72, të ligjit nr. 54/2024. Gjithashtu dhe bashkëpunimi me ministrin në rastin kur priten ndryshime të rëndësishme nga procesi që mund të kenë ndikim në objektivat e përgjithshëm politike të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 54/2024.

Në nenin 10, parashikohet vendimi i AKEP, pas përfundimit të analizës duke dhënë a) miratimin e procesit pa kushte shtesë, b) miratimin me kushte specifike që mund të lidhen me detyrimet për mbulim, me kërkesa teknike, të operimit, kërkesa ligjore etj., ose c) me refuzimin e aplikimit duke dhënë dhe arsyetimin ligjor. Miratimi shoqërohet me dhënien e autorizimit ku përcaktohen detyrimet e palëve.

Në nenin 11, kërkohet që të bëhet regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave në regjistrin e autorizimeve të AKEP si dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të AKEP.

Në nenin 12, parashikohet mbikqyrja dhe raportimin i vazhdueshëm mbi përdorimin e spektrit të transferuar ose të dhënë me qira, për të siguruar pajtueshmërinë me kushtet e licencës për autorizim individual dhe vendimin e miratimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet AKEP.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKEP, bazuar në parashikimet e Ligjit Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në praktikat e vendeve të BE.

Projekt vendimi do të dërgohet për mendim përmes e-akteve tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave.

Projekt akti do të dërgohet për mendim me shkresë pranë AKEP si dhe do të konsultohet përmes faqes së MIE me palët e interesuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku